

PKR.nr.251/12

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** gjykata e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje prej gjyqtarëve profesionistë, Suzana Çerkini, kryetare, Arben Hoti dhe Valbona Selimaj, me pjesmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. H. nga nga fshati D. M., Komuna L., për shkak të dy veprave penale, Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK dhe Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK, i akuzuar me Aktakuzë të Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Themelore në Prishtinë PP.nr.56-1/2012 të datës 28.03.2012, pas shqyrtimit të hapur kryesor, të mbajtur me datë 30.06.2017, me praninë e prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të akuzuarit F. H., me mbrojtësin e angazhuar me autorizim av. H. J., të njëjtën datë, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari F. H.,** nga i ati R. dhe nëna S., e vajzërisë S., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin D. M., Komuna L., ku edhe jtani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, puntëror në ndërtimtari, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Komfor nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP,

**REFUZOHET AKUZA**

1. Sepse nga periudha kohore e pa vërtetuar e deri më 25.12.2011 rreth orës 18:10 në shtëpinë e tij në fshatin D. M., ka mbajtur në pronësi dhe shfrytëzim të paautorizuar, pa leje përkatëse valide të organit kompetent armën-revolen e tipit “Ekol Special 99” të kalibrit 9 mm, me numër serik EU 11100821 si dhe një karikatorë të zbrazët, e cila gjatë kontrollit nga ana e policisë është gjetur dhe konfiskuar prëkohësisht,

- me çka kishte për të kryer veprë penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim, ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK ,

2. Sepse me datë, kohë, vend dhe me mjet të njëjtë të përshkruar si në pikën I të dispozitivit, ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve, ashtu që prej armës-revoles së larshënuar, ka shtënë në ajër duke shkrepur disa fishekë përderisa në afërsi të tij ishin të pranishëm grumbull i madh i njerëzve të cilët po merrnin pjesë në dasmën e vëllaut të tij,

- me çka kishte për të kryer veprë penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK,

- Për shkak se prokurori i shtetit për të dy veprat penale e precizuara në pikën I dhe II të aktakuzës është tërhequr nga akuza,
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës,

**KONFISKOHET** Arma-revolja e tipit “Ekol Special 99 cal.9mm, EU 1110-0821 dhe një karikator, të precizuara në Formularinë e dëshmisë-pronës me numër të rastit 2011-h-1601 të Nënstacionit Policor Magurë-L., të datës 25.12.2011,

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Publike e Qarkut, tani Themelore në Prishtinë me Aktakuzën PP.nr.56-1/2012 të datës 28.03.2012, ka akuzuar F. H.n për dy vepra penale, Mbjajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose shfrytëzim te paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK dhe Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarin t’a shpall fajtor dhe t’a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar në këtë çështje penale, të konfirmuar, ka mbajtur shqyrtim kryesor, në të cilin prokurori shtetit fillimisht ka bërë precizimin e aktakuzës sa i përket cilësimit juridik të veprës penale nga pika I e aktakuzës, duke theksuar se nga përshkrimi i veprimeve në dispozitivin e parë, rezulton se duhet që të pandehurit t’i vihet në barrë vepra penale nga neni 328 par.2 i KPK, ndërsa sipas kualifikimit nga paragrafi dy, kjo vepër është përfshirë në Ligjin për Amnistinë 04/L-209, (I cili ka hyrë në fuqi me date 04.10.2013, ndërsa vepra penale është kryer para datës 20.06.2013), andaj është tërhequr nga ndjekja e mëtejme penale për këtë vepër penale.

I akuzuari F. H., në prani të mbrojtësit të tij av. H. J., duke qenë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparësit e pranimit të fajsisë, si dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtin, vullnetarisht deklaroi se nuk e pranon fajsinë për veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK, andaj gjykata vazhdon me procedimin e çështjes me administrim të provave sa i përket kësaj vepre penale.

I akuzuari F. H. në mbrojtjen e vet deklaroi se, nuk e ka rrezikuar askënd meqë është larguar mbi 20-25 metra nga tenda ku ishin pak dasmorë, sepse ka qenë moti i ftoft, pra në afërsi nuk e ka pasur askënd, ka gjuajtur nga arma me gas në tokë, edhe pse nuk i njeh armët, por nuk ka qenë në dijeni se gjuajtja në dasma është e ndaluar, derisa e kishin dërguar në stacion policor, ndërsa për këtë veprim ndihet shumë i penduar, thekson se atëherë ka qenë shumë i ri, kërkon falje gjykatës dhe premtos se asnjëherë tjetër nuk do të mbajë asnjë lloj arme qoftë me apo pa leje.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoi se në kuptim të nenit 52 të KPRK tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit F. H. edhe për veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK, me arsyetimin se pas administrimit të provave dhe dëgjimit të të akuzuarit nuk është vërtetuar ekzistimi i kësaj vepre penale.

Gjykata, pas tërheqjes së prokurorit të shtetit në tërësi nga aktakuza, këtë çështje penale e konsideroi si të përfunduar dhe në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, refuzoi akuzën dhe mori aktgjykim refuzues.

Vendimin për konfiskimin e armës, gjykata e mori në bazë të nenit 60 të KPK lidhur me nenin 328 par.5 të KPK dhe në bazë të nenit 282 par.2 nënpar. 2.1 të KPP.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.251/12, datë 30.06.2017**

**Sekretarja juridike  
Ardita Azemi**

---

**Kryetarja e trupit gjykues,  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.